



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1366/ 6 prot.

Datë 26.05.2026

V E N D I M
Nr. 715/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkrytar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-83221-04-24-2026, me objekt: “*Blerje bojra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail*”, me fond limit 24,704,779 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 28.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare ShA.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Marketing & Distribution*” ShPK me NIPT J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 10, Rr. Iliria, nr. 53, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Posta Shqiptare ShA,
Adresa: Rr. “*Reshit Çollaku*” Nr. 4, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, indryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak.

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes,

II.1. Në datën 27.04.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-83221-04-24-2026, me objekt: “*Blerje bojra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail*”, me fond limit 24,704,779 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 28.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A2026/6613, datë 04.05.2026 dhe nr. 1366/2026 prot., datë 04.05.2026 e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 897/5 prot., datë 12.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1366/1 prot., datë 14.05.2026, me objekt “Shqyrtim ankesë”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranim të pretendimeve të ngritura.

II.5. Me anë të shkresës së datës 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1366/2 prot., datë 15.05.2026, operatori ekonomik ankimues “Marketing&Distribution” ShPK ka paraqitur në sistem, Formular Argumente mbi aktin e trajtimit të ankesës së tij nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Me anë të shkresës nr. 897/6 prot., datë 14.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1366/3 prot., datë 18.05.2026, me objekt “Informacion për procedurën e prokurimit”, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit informacion mbi procedurën e prokurimit dhe trajtimin e ankesës me Vendimin e KSHA-së për mospranim të pretendimeve të ngritura.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Marketing&Distribution” ShPK, mbi modifikime me argumente si vijon:

➤ Në shtojcën nr. 8 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar Kriteri 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi. Duke analizuar artikujt e kërkuar pretendojmë se vendosja e këtyre specifikimeve teknike është kërkuar ndër të tjera:

Nr	Kodi	Përshkrimi i Mallit	Njësia	Sasia
1	0928C015	VarioPrint Océ i200 Series Ink Cyan B2, ose C1	Kg	525

2	0928C016	VarioPrint Oce i200 Series Ink Magenta B2 ose C1	Kg	525
3	0928C017	VarioPrint Oce i200 Series Ink Yelloë B2, ose C1	Kg	265
4	0928C018	VarioPrint Oce i200 Series Ink Black B2, ose C1	Kg	490
5	B1 0928C013 (AA)	Rribons për pastrimin e VarioPrint i200 i set * 40 copë	Set	8

➤ Kokludojmë se per artikujt **1 deri te 4** të tabelës së mësipërme janë vendosur kodet përkatëse të cilat janë sipas faqes zyrtare të CANON (VarioPrint i-series_User guide (canon.com) dhe në Shqipëri ka vetem një kompani e cila ka autorizimin e prodhuesit për produktet e Canon.

➤ Për artikujt e lartpërmendur konstatojmë nga eksperiencia që kemi patur në ekzekutimin e kontratës së vitit 2025 për këto produkte nuk ka ekuivalencë nga prodhues të tjerë të cilët prodhojnë produkte ekuivalente por këto produkte prodhohen vetëm nga prodhuesi CANON dhe këto produkte janë vetëm origjinale.

Duke qënë se AK ka kërkuar që për të gjithë artikujt të paraqitet Autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e ofertuar, i cili duhet të përmbajë informacionin e plotë të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (emri, kontakti telefonik, adresa e email-it dhe ëbsite-i zyrtar), si dhe duke qënë para faktit që për këtë produkt nuk ka ekuivalencë, institucioni juaj në mënyrë indirekte na shpie pranë prodhuesve origjinale të produktit, veprim i cili i bie në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Gjykojmë se kriteri i mësipërm nuk është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. **Kerkojme modifikimin e kriterit per autorizim prodhuesi dhe distributor kur toneri do te jete ekuivalent dhe jo vetem nga prodhuesi i pajisjesh.**

Jemi shpallur fitues dhe kemi lidhur kontratën me nr. 1844/30 datë 17.02.2025, kontratë të cilën e kemi ekzekutuar kontratën në mënyrën më përfekte duke paraqitur mallin objekt kontrate sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, pavarësisht se në këtë procedure nuk ishte kërkuar AUTORIZIMI I PRODHUESIT.

Nga sa më sipër kërkojmë nga ana e juaj që të bëni ndryshimet e nevojshme në DST tuaj, sipas ligjit në fuqi dhe sipas vendimeve të KPP-së.

Ky kriter e pamundëson pjesëmarrjen në tender të shumë ofertuesve.

Autoriteti Kontraktor ka mënyra të tjera për të vertetuar origjinalitetin e produkteve si:

1. Vertetohet me anë të pullës së sigurisë së markës që është unike.
2. Kodi OEM i cili është unik dhe i stampuar në kuti
3. Duke kërkuar deklaratë origjinaliteti për produktin (nga ku rrjedh dhe detyrimi i OE, që produktet në raste të fitimit të tenderit të jenë konform, dhe nga ku lind dhe siguria e juaj për produktet që do të merrni në dorezim)
4. Duke kërkuar katalog teknik për produktet që kërkohen
5. Duke marrë eksperte të jashtëm të liçensuar për këtë qëllim

III.1.1.1 Autoriteti kontraktor me informacionin mbi trajtimin e ankesës ka përcjellë vendimin e KSHA-së, me argumente mbi kundërshtimin e pretendimeve të ankesës në mënyrë të përmbledhur:

[...] Kriteri nuk është kufizues vetëm për prodhuesin por AK ka parashikuar dokumente alternative **si akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi** duke e bërë që mos të jetë kufizues si kriter. Autoriteti ka vendosur kriter për të siguruar origjinën, cilësinë dhe përputhshmerinë e bojërave dhe lendeve pastruese...

AK kërkon që të shmangë produkte të paautorizuar me qëllim të mos dëmtojnë pajisjet dhe të rrisin kostot. Lenia e opsioneve në kriter rrit aksesin dhe konkurrencën.. gjithashtu kriteri nuk mund të zëvendësohet me kritere të tjera. Ky kriter është kriter standard i përgjithshëm për shumë procedura dhe lidhet drejtpërdrejtë me nevojën e Autoritetit për verifikime për burimin e furnizimit dhe me përputhshmerinë e mallrave objekt prokurimi ..[...]

III.1.2. Autoriteti kontraktor ka publikuar dokumentet e procedurës së prokurimit, Shtojcën 8, Formulari i Kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit, **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi.

III.1.2.1. Referuar Procesverbalit, Për Argumentimin dhe Miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, **AK ka argumentuar kriterin objekt ankimi:**

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. **Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike.**

Specifikimet Teknike sipas Shtojcës 6 janë përcaktuar si vijon:

Nr	Kodi	Përshkrimi i Mallit	Njësia	Sasia
1	0928C015	VarioPrint Océ i200 Series Ink Cyan B2, ose C1	Kg	525
2	0928C016	VarioPrint Océ i200 Series Ink Magenta B2 ose C1	Kg	525
3	0928C017	VarioPrint Océ i200 Series Ink Yellow B2, ose C1	Kg	265

4	0928C018	VarioPrint Océ i200 Series Ink Black B2, ose C1	Kg	490
5	B1 0928C013 (AA)	Rribons për pastrimin e VarioPrint i200 i set * 40 copë	Set	8

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

III.1.4. Neni 40, pika 3 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. ”

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumente provuese që përputhen me kërkesat e AK-së, në varësi të kontratës dhe rëndësisë që ka për autoritetin kontraktor, duke mbajtur në konsideratë rregullat e prokurimit publik.

Parë në këtë prizëm, nga shqyrtimi i elementeve të procedurës së prokurimit, Komisioni gjykon se Autoriteti kontraktor, bazuar në Testin e proporcionalitetit, duhet të vendosë kriteret kualifikuese të cilat të jenë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përcaktuar kriteret kualifikues të mirërgënjueshme në procedurat e prokurimit.

Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, qëllimi i vendosur nga ligjvënësi është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i

cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të sigurohet mbi origjinalitetin dhe besueshmërinë për blerjen e mallrave në përputhje me kërkesat për funksionimin me cilësinë e kërkuar.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik mbi modifikime të DST-së e konkretisht të heqjes së kriterit 2.3.5 me pretendimeve të ngritura në Ankresë apo mbi zëvendësimin e tij me një sërë kërkesash si: *“Autoriteti Kontraktor ka mënyra të tjera për të vertetuar origjinalitetin e produkteve si: 1. Vertetohet me anë të pullës së sigurisë së markës që është unike.*

2. Kodi OEM i cili është unik dhe i stampuar në kuti

3. Duke kërkuar deklaratë origjinaliteti për produktin (nga ku rrjedh dhe detyrimi i OE, që produktet në raste të fitimit të tenderit të jenë konform, dhe nga ku lind dhe siguria e juaj për produktet që do të merrni në dorezim)

Duke kërkuar deklaratë origjinaliteti për produktin (nga ku rrjedh dhe detyrimi i OE, që produktet në raste të fitimit të tenderit të jenë konform, dhe nga ku lind dhe siguria e juaj për produktet që do të merrni në dorezim), Komisioni gjykon se vendosja e kriterëve kualifikues duhet të jenë në përputhje me vlerën e fondit limit, me llojin e procedurës, me rëndësinë e artikujve që kanë për autoritetin në funksion të kërkesave të tij.

Për këtë qëllim AK ka vendosur kriteret kualifikuese si vijon:

2.3.2 Operatori ofertues duhet të deklarojë në ofertë se: Materialet teknologjike të pastrimit dhe bojrat teknologjike objekt kontrate, janë origjinale dhe se mban përgjegjësi të plotë juridike dhe financiare në rast të dëmtimit të pajisjes nga mospërputhshmëria e materialeve të ofertuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi, me qëllimin final të realizimit me sukses të kontratës

Operatori ekonomik në ankesë kundërshton vendosjen e kriterit 2.3.5 i cili sipas argumenteve të shprehura në ankesë mund të zëvendsohet nga kriteret te tjera të vendosura.

Autoriteti kontraktor në trajtimin e ankesës me Vendimin e KSHA-së ka argumentuar pozitën e tij dhe justifikon vendosjen e kriterit për kualifikim si një *garanci për shmangien e produkteve të paautorizuara të cilat sjellin dëmtime të pajisjeve, rrisin kosto për autoritetin .”*

III.1.6. Në analizë të fakteve dhe dokumenteve në tërësi të shtojcës 8, Komisioni gjykon se Autoriteti Kontraktor ka në dispozicion të tij, në përmbushje të qëllimit mbi sigurimin e artikujve objekt prokurimit me cilësi maksimale, origjinalitet dhe në përputhje me specifikimet teknike, dy kriterë kualifikues sipërcituar, të cilët i japin sigurinë e kërkuar Autoritetit Kontraktor, çka do të thotë se të dy kriteret kanë të njëjtin qëllim.

Me të drejtë operatori ekonomik argumenton pretendimet e tij me mundësi e verifikimi nga AK me kriterë të tjera që detyrojnë Operatorin Ekonomik të ofertojë me mallra sipas specifikimeve teknike dhe se kriteri 2.3.5 vështirëson ofertime nga operatorë ekonomikë pasi: *“... artikujt objekt prokurimi kanë kodet përkatëse të cilat janë sipas faqes zyrtare të CANON (VarioPrint i-*

series_User guide (canon.com)) dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë ka vetem një kompani e cila ka autorizimin e prodhuesit për produktet e Canon... ”

Përsa më sipër, në analizë të dokumenteve të dosjes administrative, Komisioni konstatoi se Autoriteti Kontraktor ka hartuar dy kritere kualifikuese në lidhje me origjinalitetin e mallrave objekt prokurimi dhe me anë të tyre kërkon të sigurohet mbi funksionimin e pajisjeve me bojra cilësore dhe duke evituar difektet e mundshme të pajisjeve.

Komisioni gjykon se kriteri 2.3.5 rezulton i dubluar nga kriteri 2.3.2. që në thelb janë dy kritere mbi origjinalitetin e artikujve objekt prokurimi.

Referuar sa më lart me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe respektimin e parimit të mosdiskriminimit autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kritere për kualifikim për të cilat çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në dukumentacionet e kërkuara nga AK dhe në rast të kundërt të pranojë edhe një dokument tjetër që provon cilësinë e kërkuar dhe krijon besim tek Autoriteti Kontraktor mbi përmbushjen e kriterëve dhe specifikimeve teknik mbi cilësinë dhe origjinalitetin e mallrave objekt prokurimi.

Sa më lart argumentuar në lidhje me kriterin 2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi*, Komisioni gjykon, se kriteri objekt ankimi duhet të hiqet nga kriteret për kualifikim pasi ngushton konkurrencën në kuptim të nenit 3 “Parimet e përgjithshme” të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.”

Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t’i përmbahen zbatimit të kontratës, duke ofruar mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoritet me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë apo detyrimet sipas parashikimeve të lex specialis për prokurimin publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë

20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik.

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83221-04-24-2026, me objekt: “Blerje bojra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail”, me fond limit 24,704,779 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 28.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare, ShA.
 2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të këtij vendimi.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin mbi veprimet e ndërmara duke publikuar shtojcën.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” ShPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

